



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
QEVERIA - VIADA - GOVERNMENT

## Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria - Viada - Government*

### MINISTRIA E KULTURËS, RINISË DHE SPORTIT MINISTRY OF CULTURE, YOUTH AND SPORTS MINISTARSTVO ZA KULTURU, OMLADINU I SPORT

Në bazë të Nenit 1, pika ç dhe Nenit 2 paragraf 2.1. të Rregullores së UNMIK-ut. Nr. 2001/19, mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë; nenit 13 të Ligjit për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës, Ministri, z. Valton Beqiri, më 03.02.2010, miraton këtë:

#### Rregullore

#### Për Çmimet Vjetore për Muzikë

##### Neni I.

Në bazë të Nenit 13 të Ligjit për Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës, me qëllim të zhvillimit, avancimit, publikimit dhe promovimit të krijimtarisë muzikore, Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Republikës së Kosovës themelon këto çmime vjetore për krijimtarinë artistike në fushën e muzikës:

1.1. Çmimi Kombëtar për Vepër Jetësore "Niketë Dardani"

1.2. Çmimi për veprat vokale-instrumentale e skenike (kohëzgjatja minimale 30 minuta):

- a) Operë
- b) Kantatë
- c) Oratorium

1.3. Çmimi për veprat simfonike-koncertale (kohëzgjatja minimale 20 minuta):

- a) Simfoni
- b) Balet
- c) Koncert;

1.4. Çmimi për veprat kamertale (kohëzgjatja minimale 10 minuta):

- a) Vepra për orkestër kamertale
- b) Kuintet
- b) Kuartet

1.5. Çmimi për vepra të muzikës korale (kohëzgjatja minimale 10 minuta):

- a) Vepra të muzikës korale
- b) Vepra të muzikës korale me përcjellje instrumentale

## Neni 2.

Çmimet e veprave muzikore të vlerësuara jepen në të holla, të shoqëruara nga një certifikatë dhe nga një plaketë. Për secilën kategori të evidentuar të çmimeve në nenin 1 të kësaj Rrregulloreje jepet nga një Çmim.

## Neni 3.

Shuma neto e çmimeve është si më poshtë:

Çmimi Kombëtar për Vepër Jetësore “Niketë Dardani”.....	5.000 (pesëmijë) Euro
Çmimi për veprat vokale-instrumentale e skenike.....	7.000 (shtatëmijë) Euro.
Çmimi për veprat simfonike-koncertale.....	5.000 (pesëmijë) Euro.
Çmimi për veprat kamertale.....	3.000 (tremijë) Euro.
Çmimi për vepra të muzikës korale.....	2.000 (dymijë) Euro

## Neni 4.

Çmimi Kombëtar për Vepër Jetësore “Niketë Dardani” i jepet krijuesit, artistit apo studiuesit të muzikës, i cili është shtetas i Kosovës, për kontributin e tij të veçantë dhe të gjithanshëm në fushën e muzikës.

## Neni 5.

Çmimet Vjetore për Muzikë u jepen krijuesve-kompozitorëve kosovarë të dalluar për vepra muzikore origjinale, të kompozuar brenda vitit.

## Neni 6.

MKRS shpall çdo vit Ftesë Publike për konkurrim për çmimet vjetore, e cila botohet në mediat e shkruara.

## Neni 7.

Konkurrimi për Çmimin Kombëtar për Vepër Jetësore “Niketë Dardani” dhe për çmimet vjetore bëhet individualisht apo përmes nominimit nga këto institucione:

Akademia e Shkencave dhe Arteve e Kosovës;  
Filharmonia – Opera e Kosovës;  
Fakulteti i Arteve – Dega e Muzikës;  
Baleti i Kosovës;  
Asociacionet e ndryshme të krijuesve nga fusha e muzikës.

## Neni 8.

Për vlerësimin e veprave pjesëmarrëse në Konkurs, Ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit emëron jurinë 3 (tre) ose 5 (pesë) antarëshe, e cila përbëhet nga personalitetet prominente të artit muzikor nga Kosova dhe jashtë saj. Kompensimi për punën e jurisë bëhet sipas një marrëveshjeje të veçantë.

**Neni 9.**

Secila formë muzikore e shpërbliyer paguhet veç e veç. Mjetet për dhënien e çmimeve sigurohen nga buxheti i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

**Neni 10.**

Veprat e zgjedhura nga juria profesionale për shpërblime dhe ato që konsiderohen me vlerë artistike, në bashkëpunim dhe koordinim me Filharmoninë, Operën dhe Baletin e Kosovës, mund të ekzekutohen apo të inskenohen brenda sezonit koncertal të vitit në vijim.

**Neni 11.**

Nëse në konkurs nuk arrijnë vepra me kritere të larta artistike, apo nëse konstatohet se gjatë vitit të kaluar nuk është krijuar ndonjë vepër me vlera të veçanta, juria mund të marrë vendim për mosndarjen e çmimeve.


**Neni 12.**

Çmimet i dorëzon Ministri në një ceremoni të veçantë solemne, e cila organizohet në fund të vitit.

Çmimi i dorëzohet vetë laureatit, por në raste të veçanta mund t'i dorëzohet edhe familjarëve të tij.

**Neni 13.**

Kjo Rregullore hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Ministri.

Valton Beqiri  
  
Ministër

Prishtinë, 11.03.2010

